

Në bazë të nenit 35, paragrafi 1.1 të Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.77 / 16 gusht 2010), si dhe nenet 50 dhe 85 të Ligjit nr.04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.11 / 11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 09 nëntor 2012 miratoi si në vijim:

## **RREGULLORE PËR RREZIKUN NGA AKTIVITETI ME VALUTA TË HUAJA**

### **Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të kufizojë ekspozimin e bankave ndaj rrezikut nga aktiviteti i këmbimit valutor.
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjitha bankat e licencuara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës, të cilat kryejnë aktivitetet me valuta të huaja në llogari të tyre.

### **Neni 2 Përkufizimet**

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë me termet e përcaktuara në nenin 3 të Ligjit nr.04/L-093 për banka, institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare (në vijim: Ligji për bankat) dhe/ose me përkufizimet në vijim për qëllimin e kësaj rregulloreje:
  - a. *Valutë e huaj*- do të thotë valute ligjore e ndonjë vendi të huaj, sovran.
  - b. *Pozicion neto i hapur i valutës së huaj* - do të thotë ekuivalenti Euro i ndryshimit në mes të pasurive të bankës dhe zotimeve për të blerë një valutë të posaçme, si dhe obligimeve të bankës dhe zotimeve që të shesë atë valutë.
  - c. *Pozicion i agreguar neto i hapur i valutës së huaj* - do të thotë shuma totale e Euros ekuivalent me shumën e të gjitha pozicioneve neto të hapura (në blerje ose në shitje). Për shembull, një pozicion neto i hapur valutor në blerje në franga zvicerane në shumë prej 10 mijë Euro i kombinuar me një pozicion neto të hapur valutor në shitje në dollar amerikan në shumë prej 5 mijë Euro, rezulton në pozicion neto të agreguar të hapur të valutës së huaj, në total në shumë prej 15 mijë Euro.

### **Neni 3 Limitet**

1. Asnjë bankë nuk duhet të ketë pozicion neto të hapur të valutës së huaj, në asnjë nga valutat e huaja që tejkalon 15% (përqind) të kapitalit të klasit të I-rë të saj.

2. Asnjë bankë nuk duhet të ketë pozicion të agreguar neto të hapur në valutë të huaj në total, që tejkalon 30% të Kapitalit të klasit të I-rë të saj.

3. Në rastet e degët e bankave të huaja, BQK-ja mund të përcaktojë kufizime dhe kushte të ngjashme me ato të cilat janë përcaktuar me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, mbi limitet e pozicioneve të hapura në valuta të huaja, në bazë individuale sipas rastit. BQK-ja mban të drejtën e përdorimit të depozitës ekuivalente me kapitalin si bazë e këtyre llogaritjeve nëse e konsideron të nevojshme.

#### **Neni 4 Kërkesa e informimit**

1. Së paku dhjetë (10) ditë para se të fillojë operimin aktiv të aktivitetit të këmbimit të valutave të huaja, banka duhet të informoj BQK-në për një qëllimi të tillë.

2. Për qëllim të këtij neni “*aktivitet i këmbimit të valutave të huaja*” është ai kur banka është e gatshme të tregtojë në një ose më shumë valuta të huaja ndaj kërkesave të klientëve, si qendër e profitit dhe jo thjesht si mjet i mbrojtës për të mbuluar pozicionet e bilancit të gjendjes në valuta të huaja.

3. Ekzaminimet pasuese të BQK-së në terren, do të përfshijnë edhe operimin e një aktiviteti të tillë, që të sigurohen mbi ekzistimin e kontroleve adekuate për menaxhimin e tij.

#### **Neni 5 Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile**

Çdo shkelje e kësaj rregulloreje është subjekt i masave përmirësuese dhe dënimeve të përcaktuara me nenet 58, 59 dhe 82 të Ligjit për bankat.

#### **Neni 6 Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohen Rregulla VII e BQK-së për aktivitetet me valuta të huaja e miratuar më 7 shkurt 2007 dhe çdo dispozitë tjetër që mund të jetë në kundërshtim me këtë rregullore.

#### **Neni 7 Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi me datën 03 dhjetor 2012.

Kryetari i Bordit të Bankë Qendrore të Republikës së Kosovës

---

Gazmend Luboteni